KËRKESË
Nr. 2577, datë 29.4.2015
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Lindore Tiranë, loti II (objektet)".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit, për pasuritë pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit "objekt".

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit është 38 047 272 (tridhjetë e tetë milionë e dyzet e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.

Për sa më sipër dhe në zbatim të pikës 3, të vendimit nr. 336, datë 16.5.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të botimit të njoftimeve publike, për efekt të zbatimit të ligjit nr. 8561, datë 22.12.2012, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", lutemi, konfirmimin tuaj për publikimin e kësaj kërkese për shpronësim, sipas tekstit të mësipërm dhe listës bashkëlidhur.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONESIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR "UNAZA LINDORE TIRANË" LOTI II (OBJEKTET)

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastr.	Numri Pasurisë	Sip. Totale	Lloji i pasurisë	Sip. Ndërtimi	Çmimi mesatar lek/m2	Vlera sipas preventivit (objekte jo banesë)	VLERA TOTALE (LEKE)	Shënime
1	Besim		Sallaku	1604	38/21/1	71	Ndërtesë 1kt	71		1243372	1243372	Konfirmim ZVRPP
2	Nazif Ylli	Asllan Asllan	Biba Biba	1604	38/22/1	110	Banesë 1kt	110	64500		7095000	Konfirmim ZVRPP
3	Selim	Sinan	Elezaj	1604	40/5/1	120	Banesë 1kt	120	64500		7740000	Çertifikatë pronësie
4	Fatmir	Shaban	Troksi	1604	40/6/1	130	Banesë 1kt	130	64500		8385000	Konfirmim ZVRPP
5	Petrit	Xhevit	Kodra	3976	236/3	256.3	Banesë 2kt	256.3	53000		13583900	Çertifikatë pronësie
		SHUMA									38047272	